



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 29.12.2025

Numër Protokolli: 8110/2025

A.nr.1888/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj- Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1888/2025 të datës 10.11.2025 të parashtruar nga ankuesja H.K-Sh, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1888/2025, e datës 10.11.2025, e parashtruar nga ankuesja H.K-Sh.

II. Anulohet Njoftimi i datës 09.10.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, dhe procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit me referencës RN00016741, për “Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën “Zyrtar për Regjistrimin Civil”, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 2, Drejtorja e Pajisjeve me dokumente Ferizaj, i shpallur me datë 14.02.2025, nga Ministria e Punëve të Brendshme.

III. Obligohet Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.08.2025, përmes vendimit A.nr.1139/2025, ka aprovuar ankesën e ankueses A.A, duke e anuluar njoftimin e datës 15.05.2025, për rezultatet përfundimtare dhe njoftimin për verifikimin paraprak të datës 11.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa procedura e pranimit e kthen në fazën e verifikimit paraprak.

Me qëllim të zbatimit të Vendimit të A.nr.1139/2025, të datës 15.08.2025 të KPMSHCK-së, Ministria e Punëve të Brendshme, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 09.10.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezultoi se kandidati I.B, i cili është vlerësuar me gjithsejtë 70,2 pikë, ndërsa ankuesja pas vlerësimit të dokumentacionit nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Ankuesja H.K.Sh. e pakënaqur me njoftimin e datë 09.10.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, Zyrtar për Regjistrimin Civil në QPD, Ferizaj, me datë 07.11.2025, përmes emailit zyrtar parashtron ankesën në Këshill, e cila ankesë është pranuar me datën 10.11.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se kam aplikuar në konkursin me numër referencës RN00016741, për “Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar për Regjistrimin Civil”, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 2, Drejtoria e Pajisjeve me dokumente Ferizaj, se pas përfundimit të fazës së testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, jam shpallur kandidate fituese me gjithsejtë 93.8, pikë sipas vlerësimit të Komisionit përzgjedhës dhe se me gjithë atë konkursi eshë kthyer në fazën e verifikimit paraprak, ndërsa në listën e verifikimit paraprak të datës 28.08.2025, emri i im nuk figuron dhe se pas kësaj liste nuk është publikuar asnjë njoftim për kandidatin që ka kaluar testimin me shkrim, ndërsa përmes vendimit është shpallur kandidati fitues I.B, me gjithsejtë 70.2, pikë, me tej ankuesja pretendon që Këshilli të rishqyrtojë ligjshmërinë e procedurës së rivlerësimit dhe të verifikojë nëse vendimi i MPB-së, është në përputhje me kriteret ligjore dhe faktike të përvojës së punës dhe të shfuqizojë Vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 09.10.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A. Nr.1888/2025 të datës 10.11.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 15.05.2025, për për zgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm; Njoftimi i datës 09.10.2025; Njoftimin e datës 09.10.2025, për për zgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.11.2025, dërguar nga R.K, për A.G; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1888/2025, e datës 20.11.2025; Konkursi me numër referencë RN00016741,i datës 14.02.2025; Vendimi me numër protokolli 552, i datës 04.04.2025, për themelimin e Komisionit të Pranimit i nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshëm e MPB-së; Vendimi me numër protokolli 536, i datës 01.04.2025; Lista e Aplikantëve; Njoftimi i datës 11.04.2025; Njoftimi i datës 06.05.2025; Emali i datës 06.05.2025, dërguar nga Personeli i MPB-Së; Renditja përfundimtare e kandidateve të Suksesshëm pa datë; Testi me shkrim i kandidatit të për zgjedhur; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për I.B, nga anëtari i komisionit B.S; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për I.B, nga anëtari i komisionit M.Sh; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për I.B, nga anëtari i komisionit E.A; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për I.B, nga anëtari i komisionit F.K; Formuari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në Intervistë, për I.B, nga anëtari i komisionit A.M; Aplikacioni i H.K,SH, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 587/1017, e datës 11.10.2017, për H.K, e lëshuar nga Kolegji Fama; Diplomë me numër protokolli 1011-2621/1, e datës 21.07.2023, për H.K, e lëshuar nga Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë; shkresë datës 15.11.2024; Vërtetim i datës 06.09.2017; Referencë e datës 02.09.2024; Kopje e letërnjoftimit për ankuesen; Aplikacioni i I.B, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 9736, e datës 28.12.2018, për I.B, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Vërtetim i datës 20.11.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 19.12.2018, për I.B; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 17.07.2018, për I.B; Kontratë për punë dhe detyra specifike e datës 12.04.2021; Pasqyra e trustit për I.B, për periudhën nga data 21.02.2019, deri me datën 18.02.2025; Akt Emërimi i datës 15.05.2023, për I.B; Kopje e letërnjoftimit për I.B; Njoftimi i lidhur me ankuesen H.K.SH, e lëshuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e MPB-së; emali i datës 26.08.2025, dërguar nga Personeli i MPB-së për H.K.SH; Vendimi A. Nr. 1139/2025, e datës 15.08.2025, i Këshillit; Njoftimi i datës 09.10.2025, lidhur me për zgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.02.2025 ka shpallur konkursin me referencë RN00016741, për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën "Zyrtar për Regjistrimin Civil" Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC, në Ferizaj, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 2 me afat aplikimi nga data 15.02.2025 deri me datë 16.03.2025.

Me tej, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.08.2025, përmes vendimit A.nr.1139/2025, e ka aprovuar ankesën e ankueses A.A, duke e anuluar njoftimin e datës 15.05.2025, për rezultatet përfundimtare dhe njoftimin për verifikimin paraprak të datës 11.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa procedura e pranimit e kthen në fazën e verifikimit paraprak.

Me qëllim të zbatimit të Vendimit të A. Nr. 1139/2025, të datës 15.08.2025, të Këshillit, Ministria e Punëve të Brendshme, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 09.10.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues.

Ankuesja H.K-Sh, e pakënaqur me njoftimin e datë 09.10.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, Zyrtar për Regjistrimin Civil në QPD, Ferizaj, me datë 07.11.2025, përmes emailit zyrtar parashtron ankesën në Këshill, e cila ankesën është pranuar me datën 10.11.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore sikur se janë shënuar në këtë arsyetim më lartë.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00016741, për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar për Regjistrimin Civil” Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC, në Ferizaj, dhe për pasojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Arsim i lartë i paspecifikuar;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Thënë me tepër, Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritore iu referua nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin është përcaktuar se: *Procedura e pranimit në Shërbimin Civil 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.*

Kolegji i Këshillit, nga shkresat e lëndës konstaton së Ministria e Punëve të Brendshme, pas pranimi të vendimit A.nr. 1139/2025, të datës 15.08.2025, të Këshillit, procedurën e rekrutimit sipas konkursit referencë RN00016741, për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar për Regjistrimin Civil” Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC, në Ferizaj, e ka kthyer në fazën e verifikimit paraprak, mirëpo edhe përkundër faktit së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka kthyer çështjen në fazën e verifikimit paraprak Ministria e Punëve të Brendshme, me datën 20.11.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë ku ka bashkangjitur njoftimin me numër protokolli 612, të datës 11.04.2025, të cilin njoftim e ka anuluar Këshilli A. Nr. 1139/2025, të datës 15.08.2025 dhe me qëllim të sqarimit të situatës juridike sa i përket listës së ngushtë, Zyrtari për bashkëpunim profesional me datë 22.12.2025, përmes emailit ka kërkuar nga Udhëheqës i Njësise për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që të bashkëngjitet lista e ngushtë e kandidateve, ndërsa me të njëjtën datë i njëjti email, përmes të cilit e emaili e ka bashkëngjitur listën e ngushtë të datës 11.04.2025, me numër protokolli 612, e që është e njëjta sipas vendimit të Këshillit e cila listë është anuluar.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se Ministria e Punëve të Brendshme, në rastin e zbatimit të vendimit A.nr. 1139/2025, të datës 15.08.2025, të Këshillit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 dhe nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, ku përcaktohet se: *“21.1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës, sepse në rastin konkret Ministria e Punëve të Brendshme **nuk ka vepruar** sipas vendimit A.nr. 1139/2025, të datës 15.08.2025, të Këshillit, ku sipas vendimit të Këshillit Ministria e Punëve të Brendshme ka qenë e obliguar që të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, të hartoj listën e ngushtë për pozitën Zyrtar për Regjistrimin Civil”* Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC, në Ferizaj, gjithashtu nga shkresat e lëndës pavarësisht që NMBNJ nuk e ka bërë verifikimin paraprak me dëshmi të mjaftueshme dhe nuk ka bërë njoftim publikë për kandidatët që i plotësojnë kushtet për përfshirje në listën e ngushtë, megjithatë ka nxjerr një njoftim pa datë pa protokoll, sipas të cilit ankuesja H.K.SH nuk i plotëson kriteret për përfshirje në listën e ngushtë, ndërsa në procedurën që e parë të cilën e ka anuluar KPMSHCK e njëjta ka qenë kandidate fituese.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se nga shkresat e lëndës del se Renditjen përfundimtare të kandidateve, është nënshkruar vetëm nga një anëtar i komisionit të pranimi, e që është në kundërshtim me nenin 11, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku shprehimisht thuhet se; *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimi përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNJ, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Si rrjedhojë, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se, Ministria e Punëve të Brendshme, pas pranimit të vendimi të Këshillit, duhet ta anuloi konkursin e datës 14.02.2025 me numër të referencës RN00016741, për Grupin i Administrimit të Përgjithshëm”, për pozitën ”Zyrtar për Regjistrimin Civil” Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente ARC, në Ferizaj’, si dhe njoftimin e datës 09.10.2025, për përzgjedhjen përfundimtare për kandidatin fitues për pozitën ‘Zyrtar për Regjistrimin Civil”, dhe të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe duhet të merr parasysh Ligji për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197 gjegjësisht nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.17 ku përcaktohet se “ *keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil*”.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Thënë si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS LËNDA, A.nr.1888/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses H.K- Sh;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së